




Pranimi / Dorezuar Punësimi/Prestato Receipts/Delivery	28.12.2023	viti god year	3
Organ /Njësia Organ /Jedinita Org /Unit	SKIMSHOCK	Shtojca Prilog Appendix	7715/2023
Id. Prot Id. Prot Prot No		Sasia Kolicina Quantity	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1412/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1412/2023, të datës 14.11.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.12.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1412/2023, e datës 14.11.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet** Akt Emërimi AE. Nr.07/2023, i datës 11.10.2023, për pozitën Zyrtar për pritje dhe akomodim në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion/Qendra e Pritjes së Përkohshme Vranidoll, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- III. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi sikurse në pikën II të këtij dispozitivi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje vetëm ankuesi), më datë 14.11.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që të shfuqizohet Akt Emërimi AE. Nr. 07/2023 i datës 11.10.2023, për pozitën Zyrtar për pritje dhe akomodim dhe i njëjti të sistemohet në një pozitë në bazë të përgatitjes profesionale sipas Marrëveshjes për Bursë numër

protokolli 1597, të datës 13.10.2008 2008-2012 dhe Aktgjykimit AC.nr.4309/2022, të datës 30.05.2023, të Gjykatës së Apelit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit më datë 01.12.2023. ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6976/2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Marrëveshjen për Bursë, 2008-2012 me numër protokoll 1597 e datës 13.10.2008 e nënshkruar nga ankuesi dhe Ministria e Punëve të Brendshme; Kërkesën për informacion financiar me numër protokoll 150 të datës 27.02.2015 nga Drejtoresha e Departamentit për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Punëve të Brendshme për Drejtorinë e Agjencisë Kundër Korrupsionit bashkë me tabelën e shpenzimeve në analitikë nga viti 2008-2015 me numër protokoll 02-02/570/15 e datës 27.02.2015; Listën e pagesave për studentet nga Policia e Kosovës për periudhën 2011-2015; Vendimin me numër Ref.Nr.2/6-2262 i datës 31.05.2022 i lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me të cilin z. [] i njihet grada "Specialist i Sigurisë"; Shkresën me Nr:40843807-43203/218 nga Drejtori i Akademisë Policore në Turqi; Aktgjykimin AC.nr.4309/2022 të datës 30.05.2023 të Gjykatës të Kosovës; Aktgjykimin C.nr.7443/2021 të datës 26.01.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile; Aktin e Emërimit AE.Nr.07/2023 të datës 11.10.2023; E-mailin e datës 02.10.2023 nga Menaxheri i Personelit i MPB-së për ankuesin; E-mailin e datës 02.10.2023; E-mailin e datës 09.11.2023 nga ankuesi për Menaxherin e Personelit në MPB; Informatat personale për Diplomën me Nr.14153 nga Akademia Policore e Turqisë për [] Listën e të diplomuarve në Akademinë Policore; Shkresën e Bordit të Akademisë Policore-Fakulteti i Shkencave të Sigurisë me të cilën dëshmohet se [] ka diplomuar i pari nga Kosova; Referencën për [] e datës 10.12.2020 nga Menaxheri i programeve T.I.P; Referencën nga Besasecurity; Referencën të datës 04.07.2023 nga Kompania e përkthimeve "Prestige"; Referencën e datës 17.06.2019 nga Drejtori Gjeneral në "Emerald Hotel"; Certifikatën e datës 21.02.2019 e lëshuar nga GFS ; Certifikatën e datës 26-27.04.2011 nga Akademia Policore e Turqisë; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.11.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 01.12.2023 nga organi i punësimit lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes; Organogramin e Ministrisë së Punëve të Brendshme; Rregulloren (ZKM) Nr.03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores(ZKM) Nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Pasqyra e llogarisë së Trustit për periudhën 19.05.2015-09.10.2023 dhe Njoftimin e datës 02.08.2023 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit për Avokaturën Shtetërore.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Ministria e Punëve të Brendshme (tuje MPB), bazuar në ofertën e Ambasadës Turke të datës 27.08.2008, që të pranoj pesë zyrtarë policore të Kosovës, për studime në Fakultetin e Shkencave të Sigurisë të Turqisë, më datë 13.10.2008, kishte lidhur marrëveshje me ankuesin si përfitues i bursës, me kushtin që ankuesi pas studimeve të kthehet



në Kosovës dhe të punoj për MPB apo në institucionet pasardhëse. Rrjedhimisht sipas Marrëveshjes për Bursë, 2008-2012, me numër të protokollit 1597 të datës 13.10.2008, pika 2. nën pika 2.1 është përcaktuar së MPB-ja ose cilido paraardhës i saj, menjëherë pas marrjes së dëshmisë për përfundimin e studimeve, duhet ti ofroj përfituesit kontratë të rregullt pune në kuadër të MPB, agjencive të saj (Policisë së Kosovës) dhe jo më vonë së tre muaj kalendarik pas marrjes së dëshmisë, për një periudhë prej së paku 10 vitesh. Vendi i punës do të përcaktohet duke u bazuar në organizmin e brendshëm të MPB-së-Policisë së Kosovës apo pasardhësve të saj.

Me tej sipas thënieve në ankesë rrjedhë së ankuesi pas përfundimit të studimeve bachelor, ka kërkuar kohë shtesë nga MPB-ja, me qëllim të vazhdimit të studimeve Master, ku me Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së ka vazhduar studimet master prej vitit 2012 deri në vitin 2014, në drejtimin e Sigurisë Ndërkombëtare. Në vitin 2014 ankuesi kishte paraqitur dokumentacionin për punësim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në pajtim me Marrëveshjen për Bursë të datës 13.10.2008, mirëpo, që kjo e fundit nuk kishte ofruar ndonjë vend pune për ankuesin.

Ankuesi, se bashku me gjashtë (6) paditës të tjerë, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-, Divizioni për Çështje Civile, për shkak të mos zbatimit të marrëveshjeve për bursë të datës 13.10.2008. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, me Aktgjykimin C.nr.7443/2021 të datës 23.12.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, në këtë rast ankuesit, duke detyruar të paditurën Ministrinë e Punëve të Brendshme që marrëveshjen e lidhur me datë 13.10.2008 të nënshkruar nga palët ndërgjyqësore për secilin paditës të përmbushë detyrimet e veta nga këto marrëveshje, paditësve të ju ofrojë kontrata të rregullta pune, sipas përgatitjes shkollore sipas pikës 2.1 të marrëveshjes, aktgjykim i cili ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin AC. Nr.4039/2023 të datës 30.05.2023.

Ministria e Punëve të Brendshme pas refuzimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga Prokuroria e Shtetit, më datë 11.10.2023, ankuesit i ka lëshuar Aktin e Emirit me numër AE. nr.07/2023 dhe numër të protokollit 1871/2023 të datës 12.10.2023, duke sistemuar ankuesin në pozitën *Zyrtar për Pritje dhe Akomodim*. Ankues, duke vlerësuar së pozita në fjalë nuk përkon me kualifikimet e tij shkollore, parashtron ankesë në Këshill, më pretendimin që sistemi i ankuesit sipas Akti të Emirit me numër AE. nr.07/2023 nuk është në harmoni me vendimin e gjykatës së apelit, përgatitjes shkollore dhe titujve të fituar në studime si specialist i sigurisë.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka analizuar provat materiale të çështjes, dhe si rrjedhojë konstatoi se Gjykata Themelore Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, me Aktgjykimin C.nr.7443/2021 të datës 23.12.2021, i plotfuqishëm sipas Aktgjykimit AC. Nr.4039/2023 të datës 30.05.2023, të Gjykatës së Apelit, ka detyruar të paditurën Ministrinë e Punëve të Brendshme që të përmbushë detyrimet e veta sipas marrëveshjeve të lidhura me datë 13.10.2008 e të nënshkruar nga palët ndërgjyqësore dhe së paditësve të ju ofrojë kontrata të rregullta pune, sipas përgatitjes shkollore sipas pikës 2.1 të marrëveshjes. Kështu që nisur nga fakti së vendimet gjyqësorë të formës së prerë të nxjerra në procedurë kontestimeve janë të detyrueshme për palët ndërgjyqës siç përcaktohet me nenin 167 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, Kolegji i Këshillit në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka trajtuar pretendimet ankimore të ankuesit, vetëm në kuptimin e sistemit të ankueset në pozitën e nëpunësit civil në pajtim me pikëpamjet juridike si në aktgjykim C.nr.7443/2021 të datës 23.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Andaj, mbi



ketë bazë, Kolegji ka shqyrtuar përshkrimin e detyrave të punës për pozitën *Zyrtar për pritje dhe akomodim* në Qendrën e Pritjes së Përkohshme për Migrantë, Ministria e Punëve të Brendshme, ku si kritere për këtë pozitë të punës janë vendosur: **Arsimi:** diplomë e arsimit të lartë, se paku 3 vite të studimeve në fushën e paspecifikuar; **Përvoja:** së paku një vit përvoja pune profesionale, dhe si rrjedhojë në vlerësimin e Kolegjit sistemi i ankuesit në pozitën e punës Zyrtar për pritje dhe akomodim, nuk është në përputhje me përgatitjen arsimore të ankuesit.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur, aprovoj ankesën e ankuesit si të bazuar, anuloj Akt Emërimin AE. Nr.07/2023, të datës 11.10.2023, për pozitën Zyrtar për pritje dhe akomodim dhe çështjen e kthej në rishqyrtim të organi i njëjtë. Rrjedhimisht Ministria e Punëve të Brendshme në ri procedurë duhet të rishqyrtoj çështjen e sistemit të ankuesit në mënyrë që i njëjti të sistemohet në pozitë të punës sipas përgatitjes se tij shkollore ashtu siç është përcaktuar edhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin C.nr.7443/2021 të datës 23.12.2021.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 1412/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

